

VENDIM
Nr. 1071, datë 23.12.2015

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MBROJTJES SOCIALE 2015–2020 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT, PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015–2020 dhe të planit të veprimit, për zbatimin e saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efekti financiar i zbatimit të strategjisë, për vitin 2015, është 184 800 000 (njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e tetëqind mijë) lekë dhe do të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama